



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:055376

Datë: 18.02.2025

Numri i dokumentit: 06863479

**C.nr.962/2024**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Shyqri Hoxha, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional L.Ç. në çështjen juridike të paditësit R.Sh. nga fshati Buqe, Komuna e Dragashit, me numër personal ..... të cilën me autorizim e përfaqëson avokat B.K. dhe F.G. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi në pagë konform licencimit – kualifikimit, me vlerë të kontestit 1,562.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 18 shkurt 2025, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Pa shqyrtim kryesor të çështjes**

- I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpapia e paditësit R.Sh. me të cilën ka kërkuar kompensimin e pagës në emër të kualifikimit – licencimit, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit që në emër të kompensimit në pagë konform licencimit – kualifikimit të paguajë shumën dhe atë për periudhën kohore 01.05.2021 – 31.12.2022, për 35% të pagës bazë (459 euro), në emër të diferencës së papaguar prej 78.10 euro, për 20 muaj, shumën prej 1,562.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e parashtrimit të padisë (13.02.2024), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.
- II. **OBLIGOHET** e paditura Komuna e Prizrenit, që në emër të shpenzimeve procedurale të paguajë shumën prej 134 euro, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

**Arsyetim**

Paditësi, përmes të autorizuarve të tij, pranë kësaj gjykate me 27.02.2024, ka parashtruar padi me numër C.nr.1324/2024, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me të cilën ka kërkuar kompensim në pagë, lidhur me

kualifikimin - licencimin, për periudhën kohore 01.05.2021 - 31.12.2022, për 35% të pagës bazë, në emër të diferencës së papaguar në pagë prej 78.10 euro, për 20 muaj, shumën prej 1,562.00 euro. Shpenzimet gjyqësore i ka kërkuar në shumën prej 156 euro, si dhe kamatën ligjore prej 8% prej momentit të parashtrimit të padisë.

E paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi, ku ka theksuar se pretendimet e paditësit se i takon kompensimi deri më 31.12.2022, janë ta pabazuara për arsye se në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 e datës 05.10.2023, rastet e të punësuarve që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, duhet trajtuar deri me datë 21.11.2022, kur kjo kontratë është shkëputur nga njëra prej palëve kontraktuese. Po ashtu ka theksuar se në bazë të njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/ të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 padia dhe kërkesëpafia e paditëses është e pa bazuar. Pretendimet e paditëses se i takon kompensimi për licencim dhe kualifikim është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësja ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të saj pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Pafia është në kundërshtim të plotë me nenin 124, par.6.1 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, si dhe komunës me këtë veprim i shkaktohen shpenzime të mëdha. Pretendimet e paditësit se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Në fund ka theksuar se bazuar në nenin 35 të KKAK-së, e drejta për licencim apo kualifikim, nuk është e përfshirë si detyrim për kompensim, çka padinë e paditësit e bënë tërësisht të pa bazuar, gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pabazuara. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK, gjeti se kërkesëpafia e paditësit është e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura SH.L.P. "Ymer Prizreni", në Prizren, si mësimdhënës. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësit i takon e drejta e kompensimit

të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të paguar.

Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes provave dhe atë: Përmes Diplomës me numër D-29/2014, i datës 05.01.2015, lëshuar nga Kolegji Universi, Programi për Kulturë Fizike, Sport dhe Rekreacion, me të cilën shihet se i njëjti ka përfunduar studimet master, duke marr titullin Master Kulturë Fizike, Sport dhe Rekreacion. Në bazë të licencës së mësimdhënësit me numër 100012479, shihet se i njëjti ka pasur licencë të karrierës për periudhën 01.03.2013 – 01.03.2018. Në bazë të kontratës së punës me numër 215, shihet se paditësi është i punësuar pranë kësaj shkolle si profesor i edukatës fizike. Ndërsa, sa i përket diferencës së paguar të pagës, gjykata është bazuar në listën e pagave me numër 10-94471-622-0922, për muajin maj 2021, ku shihet se i njëjti është kompensuar në emër të kualifikimit – master, një pjesë dhe atë në shumën prej 82.55 euro.

Andaj, Gjykata, me rastin e aprovimit në tërësi të kërkesëpadisë së paditësit dhe përcaktimit të lartësisë për kompensimin e diferencës në pagë për punonjësit me licencim-kualifikim, është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, e nënshkruar në mes të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 01/33, të datës 29.08.2008.

Sipas dispozitës së nenit 7 paragrafi 1, pika 3 dhe pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e datës 18.04.2017, është paraparë se: *“Me Licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katërvojçar, 27 % e pagës bazë.”*

Gjithashtu, në bazë të kontratës kolektive të arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021, në nenin 7 për licencim thuhet se: *“Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e licencës së fituar, bazuar në UA Nr. 5/2017 Sistemi i licencimit dhe i zhvillimit të mësimdhënësve në karrierë, u mundëson mësimdhënësve realizimin e stimulimit në të ardhurat personale, si vijon: 1.1 Mësimdhënës me Licencë të karrierës 10 % e pagës bazë. 1.2 Mësimdhënës me Licencë të avancuar 10% e pagës bazë. 1.3 Mësimdhënës me Licencë mentor 15% e pagës bazë. 1.4 Mësimdhënës me Licencë meritator 15% e pagës bazë”.*

Në vendimin e Qeverisë Nr.01/33, të datës 29.08.2008, në paragrafin 4 pika 2, 3, 4 përcaktohet se *“Mësimdhënës me nivelin master të studimeve përfitojnë 35% të pagës bazë.”*

Edhe në bazë të Mendimit Juridik, me nr.prot.214/2013, të datës 09.10.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës, është paraparë se dispozita e nenit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës e datës 17.04.2017 dhe Kontratës në fuqi të datës

22.01.2021, ka karakter detyrues, për palët nënshkruese, në rastin konkret për të paditurën Komunën e Prizrenit.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se *“shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Duke u bazuar në dispozitat e lartë cekura të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, si dhe dispozitave tjera ligjore dhe gjendjen faktike të vërtetuar, gjykata e aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditëses sa i përket kompensimit të pagës në pajtim me kualifikimin - gradimin - licencimin dhe e detyroi të paditurën, që t'ia paguaj shumën monetare dhe atë atë për periudhën kohore 01.05.2021 - 31.12.2022, për 35% të pagës bazë (459 euro), në emër të diferencës së papaguar prej 78.10 euro, për 20 muaj, shumën prej 1,071.00 euro, ( $35\% \times 459 \text{ euro} = 160.65 \text{ euro} - 82.55 \text{ euro} = 78.10 \text{ euro} \times 20 \text{ muaj} = 1,562.00 \text{ euro}$ ) me kamatë ligjore prej 8%, nga data e parashtrimit të padisë (13.02.2024), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 të LPK-së, ku parashihet që *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”, andaj ka vendosur si në pikën nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi”*.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (06.11.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par.1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t'ia paguajë shumën e

përgjithshme prej 134.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumë prej 104.00 euro dhe për taksë gjyqësore shumë prej 30.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 143 dhe 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL**  
**C.nr.962/2024, dt.18 shkurt 2025**

**Gjyqtari**  
**Shyqri Hoxha**

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.